



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 378/2 Prot.

Gjirokastrë, më 31/03/2021

V E N D I M

Nr. 10, datë 31.03.2021

**MIRATIMI I MBYLLJES SË DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË
PARË DHE CIKLIT TË DYTË**

Në zbatim të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 35 pika 7, udhëzimit nr 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programet e studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Kreu IV pika C, udhëzimit nr 23, datë 28.09.2020, për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programet e studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", si dhe vendimeve të njësive kryesore të FESHSH me nr. 03 datë 12.03.2021 dhe FSHN nr.4 datë 18.03.2021 për arsye se për më shumë se 3 vite të njëpasnjëshme nuk ka pasur studentë të regjistruar, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 31.03.2021;

V E N D O S I:

1. Të miratojë mbylljen e programeve të studimit sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të mos parashikojë kuota pranimi për vitin akademik 2021-2022
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA

